



2.D/DPK1

01-404/2012

31.01.2012



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë, 30.01.2012 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-3990/11, për z.Besnik Berisha, Drejtorë i Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve në Ministrinë e Punëve të Brëndshme, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-3990/11, është zhvilluar procedura e trajtimit të situatës së konfliktit të interesit gjatë ushtirimit të funksionit publik ndaj z.Besnik Berisha, Drejtorë i Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve në Ministrinë e Punëve të Brëndshme krahas funksionit të tij në biznesë privatë, ku ka qenë pronarë dhe person i autorizuar në dy biznese “N.SH.Festina dhe N.SH.Festina” dhe që ka paraqitur Konflikt të mundshëm të Interesit

Zyrtarit të lartë z.Besnik Berisha i është bërë shkresa e parë njoftuese, dhe jemi takuar me të për ta njoftuar me situatën që gjindët dhe me faktet që posedon Agjencia.

Gjatë takimit me zyrtarin e lartë z.Berisha është pajtuar për situatën që gjindët dhe ka premtuar së brenda afatit ligjorë do të bëjë ndryshimet e kërkuara dhe do ta shmangë konfliktin e interesit.

Pas zhvillimit të procedurës, zyrtari i lartë me datën 26.01.2012 ka sjellë deshmhtë se ka bërë ndryshimet e kërkuara në biznes dhe ka vepruar sipas procedurave .

Konstatohet se zyrtari i lartë publik z.Besnik Berisha ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej:

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtarit ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

